

VENDIM
Nr.194, datë 10.4.2004

PËR PËRPARËSITË, FUSHAT DHE NIVELET E BASHKËPUNIMIT TË SHËRBIMIT
INFORMATIV TË SHETIT ME SHËRBIMET INFORMATIVE TË VENDEVE TË HUAJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 16 të ligjit nr.8391, datë 28.10.1998 "Për Shërbimin Informativ Kombëtar", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi Informativ i Shtetit, për realizimin e detyrave për sigurimin kombëtar, bashkëpunon me shërbimet informative të vendeve të huaja, në përputhje me parimet e respektimit e të besimit të ndërsjellë, të barazisë dhe respektimit të pavarësisë.

2. Bashkëpunimi realizohet në funksion të:

a) Përparësive, ku përfshihen:

- çështjet që kanë lidhje, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë;

- çështjet e diktuar nga siguria rajonale;

- detyrimet që lindin nga aleancat strategjike të shtetit.

b) Fushave të bashkëpunimit që janë:

- shkëmbimi i të dhënave;

- mbështetja logjistike;

- shkëmbimi i përvojave dhe trajnimit;

- modernizimi i segmenteve tekniko-shkencore;

- kryerja e detyrave dhe e operacioneve të përbashkëta;

- përdorimi i ndërsjellë i burimeve për zgjidhjen e detyrave të përbashkëta, brenda dhe jashtë vendit.

c) Nivelit:

- Formal - Në këtë rast Shërbimi Informativ i Shtetit mban thjesht kontakte njohjeje me shërbimin e vendit tjetër, ku mund të paraqiten punonjësit e tyre zyrtarë të akredituar në të dy vendet. Në këtë nivel ndërmjet shërbimeve nuk shkëmben të dhëna, si dhe nuk ndërmerren veprime të përbashkëta.

- Normal - Në këtë rast Shërbimi Informativ i Shtetit shkëmben të dhëna me shërbimin informativ të huaj dhe kryen veprime të përbashkëta, në funksion të përparësive, të miratuara nga Kryeministri. Në këtë nivel dy vendet ruajnë raporte dhe marrëdhënie të mira politike.

- Optimal - Në këtë rast Shërbimi Informativ i Shtetit bashkëpunon ngushtë me shërbimin informativ të huaj, në të gjitha fushat, për realizimin e përparësive, duke ndërmarrë e duke kryer edhe operacione të përbashkëta.

Gjatë bashkëpunimit me shërbimet informative të huaja ruhet identiteti i burimeve të të dhënave.

3. Përparësitë, fushat dhe nivelet e bashkëpunimit, me secilin shërbim informativ të huaj, miratohen nga Kryeministri, me propozimin e drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.

4. Në rastet kur, për zgjidhjen e detyrave të përbashkëta, është i domosdoshëm dërgimi jashtë Republikës së Shqipërisë i burimit të Shërbimi Informativ të Shtetit, ai shoqërohet, drejtohet dhe kontrollohet nga inspektori, që e mban në lidhje. Kur është e nevojshme inspektori bashkëpunon dhe mbështetet edhe nga inspektorë të tjerë të këtij shërbimi.

5. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit krahas njoftimit të rregullt, një herë në gjashtë muaj, i dërgon Kryeministrit një raport, me shkrim, për përparësitë, nivelet dhe fushat e bashkëpunimit me shërbimet informative të huaja.

6. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit, nëpërmjet udhëzimeve, përcakton:

a) procedurat që do të zbatojnë njësitë dhe punonjësit, për bashkëpunimin dhe shërbimet

informative të huaja;

b) dokumentacionin që do të përdoret për realizimin e këtij bashkëpunimi;

c) rregullat për grumbullimin, ruajtjen, administrimin dhe shpërndarjen e dokumentacionit, që prodhohet nga ky bashkëpunim;

ç) rregullat për marrjen, për ruajtjen dhe për administrimin e vlerave, materiale dhe monetare, që rrjedhin nga bashkëpunimi me shërbimet informative të huaja;

d) procedurat e përdorimit të ndërsjellë të burimeve për zgjidhjen e çështjeve të përbashkëta, brenda dhe jashtë vendit;

dh) procedurat për kryerjen e detyrave dhe të operacioneve të përbashkëta.

7. Ngarkohet drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano